

Mr. Azis GJERGJI

TEQEJA E PEZËS - VATËR ATDHETARIE

Teqeja dhe tyrbja e Baba Hasanit të Pezës nuk janë trajtuar në ndonjë studim të veçantë në fushën e historisë së institucioneve të kultit islam në Shqipëri; përveçse janë përmendur në botimet: *Tarikatet islamike shqiptare. Saadizma* (Tropojë, 1995) dhe *Tarikati Islamik "Saadi"* (Tiranë, 1996), të autorit Sheh Ismail Halil Aga. Ky autor na bën me dije se teqeja e Baba Hasanit të Pezës i takonte tarikatit islam *Saadi* dhe ishte një nga më të vjetrat në llojin e vet, të ngritura gjatë shekullit XVIII në mbarë trevat shqiptare. Të dhënat e Sheh Agës i ka trajtuar edhe studiuesi Jashar Rexhepagiq në librin e tij *Deroishët, rendet dhe teqetë* (Pejë, 1999). Në studimin *Histori e komuniteteve fetare shqiptare* (Tiranë, 2006), historiani Shyqyri Hysi ka arritur në të njëjtin përfundim, duke u mbështetur në një raport të Drejtorisë së Dytë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë, të vitit 1958. "Gjatë shekullit XVIII, shkruan Hysi, *saadi*-të ngritën teqetë e tyre në Gjakovë, në Prizren, në Fushë-Kosovë, në fshatin Mazhar të Sevasterit (Vlorë), në Pezë të Tiranës (theksimi im-A.GJ.), në Elbasan, në Peqin, në Kavajë etj." ¹⁾

Në të vërtetë, Peza nuk ka pasur ndonjëherë ndërtesë të veçantë si *teqe*, ku të priteshin e të përcilleshin besimtarët dhe të kryheshin ceremonitë fetare; rolin e saj e ka luajtur *shtëpia-teqe* e Baba Hasanit, mbi themelet e të cilës sot ngrihet shtëpia ku është mbajtur Konferenca I Antifashiste Nacionalçlirimtare e Pezës, gjatë Luftës së Dytë Botërore (16 shtator 1942). Gjithashtu, *tyrbja* e ngritur në vitin e ndërrimit të jetës së Sheh Hasanit (1786), përbri shtëpisë-teqe, u rrafshua gjatë fushatës së panevojshme antifetare që ndërmoi Partia e Punës në pushtet, në vitin 1967. Tyrbja e rindërtuar në vitin 1995, ndonëse ruan brenda *mekamin* (varrin) e Sheh Hasanit, përfaqëson vetëm një shëmbëlltyrë

modeste të ish-tyrbes së madhe të tij. "Teqetë e Shqipërisë u ndërtuan me kërkesat kanonike të secilit urdhër mistik, duke pasur pa përjashtim sallën e faljeve të emërtuar *Mejdani*", shkruan Sulejman Dashi në artikullin "*Teqetë e Shqipërisë. Aspekte të historisë dhe të arkitekturës*", botuar në revistën "Perla", 1999/1. "Për *mejdanin*, thekson ai, nuk ka ndonjë rregull: ai bën pjesë si volum i veçantë ndaj ndërtesave të tjera ose zgjidhet një dhomë e banesës, kryesisht në katin e parë. Përbërës i teqesë është detyrimisht *Mekami*".²⁾

Stërnipërit e Baba Hasanit në Pezë dëshmojnë se rolin e "*Mejdanit*", siç e emërton Dashi, ose të *simahanjës* (arabo-pers: *ambientit ku kryheshin ceremonitë fetare*), si dhe të *mysafirhanjës* (arabo-pers: *dhomës së pritjes, ngrënies e fjetjes së miqve*) të banesës së rojtarit, siç quhej shehu në terminologjinë fetare të kohës, e kanë luajtur dy dhomat e poshtme të shtëpisë-teqe të Sheh Hasanit. Po si arriti të emërohej Sheh Hasani i Pezës? Një gojëdhënë e transmetuar brez pas brezi nga farefisi i themeluesit të teqesë së Pezës, thotë:

"Hasani pat vra një njeri në rininë e vet. E pat vra, vetëm pse e rrejtë. E vrau dhe u arratis në mal, ku u bashkue me të arratisun të tjerë. Në mal, Hasani arriti të krijonte edhe një çetë me dyzet vetë. Një ditë prej ditësh, Hasani zbriti në qytetin e Prizrenit, ku vizitoi teqen e bukur të tarikatit "Saadi", që ngrihej pranë një rrapi në lagjen Marash. Atje dëgjoji se themeluesi i atij tarikati, Saad Al-Dini, kishte pasë në rininë e vet një histori të ngjashme me të tijën. Kështu, tuj ndjekë shembullin e atij shenjtori të madh, Hasani e la jetën e kaçakut dhe u dorëzue dervish në atë teqe..."³⁾

Në një nga ekspeditat për mbledhjen e zërave të botimit të dytë të "*Fjalorit enciklopedik shqiptar*", dy vjet më parë, ne ndaluan në lagjen Marash të Prizrenit dhe pyetëm për teqenë e famshme të tarikatit *Saadi*. Rrapi madhështor ku ishte ngritur Teqeja e Marashit, gjendej akoma buzë trotuarit të shtratis të lumit Bistrica, por ish-teqeja "nga më të bukurat në pikëpamje arkitektonike në Kosovë", siç shprehet Rexhepagiq; ishte rrënuar në vitin 1950. Pranë rrapit të Marashit, në vend të teqesë ngrihej një ndërtesë e thjeshtë me një varrezë të zbuluar në oborrin e saj. Gjithsesi, nën rrapin shekullor të Marash-Hisarit, afro dy shekuj e gjysmë më parë, kaçaku i penduar

Hasan, i ardhur nga Peza e largët, kishte vendosur të dorëzohej dervish në atë teqe dhe të ndiqte deri në vdekje shembullin e themeluesit të tarikatisë, *Saad Al-Din Al-Xhibaviut*.⁴⁾

Në zërin *Saad Al-Din* të enciklopedisë së tij "*Kamus Al-A'Lam*" (Fjalor i Historisë e Gjeografisë), vëllimi IV, i botuar në vitin 1894, dijetari shqiptar *Sami Frashëri* thotë: "*Saadedin Xhibavi*, i biri i Musa Shibaniut, është një nga *shënjtoret* dhe themeluesit e tarikateve muslimane. Është nga fshati Xhiba, që ndodhet në Siri, midis Horanit dhe Kudusit. Është themelues i tarikatisë të *saadijve* (arab: "Sa' diyya")." Në lidhje me incidentin e ndodhur në rininë e *Saad Al-Dinit*, Baba Ali Tyrabiu në librin e tij *Historia e Përgjithshme e Bektashinjve* (Tiranë, 1929) shkruan: "Në rininë e tij, Sadedin Xhibaviu *doli kaçak për një vrasje*, por, me këshillat e vazhdueshme të atit të tij, u nis për në Mekë. Aty ndoqi studimet fetare dhe, pas një kohe, u kthye në Siri, ku filloi të predikonte mësimet e marra në Mekë. Në atë kohë, në horizontin e botës arabe u dukën *turqit selxhukë* që pretendonin se sulltani i tyre ishte zëvendës i Muhamedit. *Saad Al-Dini* shkroi dhe propagandoi në një libër të tij jetën e vërtetë të Muhamedit, i cili as që e kishte marrë me mend se kishte *turq në këtë botë*. Predikimet e *Saad Al-Dinit* zunë vend në mendjet e shumë njerëzve, të cilët krijuan tarikatin e madh e të fuqishëm *Saadi*." Sipas dijetarëve Sami Frashëri e Jashar Rexhepagiq, por edhe shumë të tjerëve, *Saad Al-Dini* e ka themeluar tarikatin e tij në fund të shekullit XIII dhe ka vdekur në vitin 1335. Po ashtu, është një e vërtetë e pranuar nga të gjithë se "tarikati "*Saadi*" është nga tarikatët më të dëgjuar në Shqipëri dhe botën islame".⁵⁾

Depërtimi dhe përhapja e tarikatisë "*Saadi*" në trojet shqiptare

Studiuesi anglez *H. T. Norris*, në librin e tij "*Islami në Ballkan*" (1993), thekson se Urdhri *Saadi* u shtri fillimisht në Turqi dhe Egjipt dhe, më pas, në shekullin XVIII, fitoi terren në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri. Duke iu referuar studiuesit *Muhamed Mufaku*, Norris shpreh mendimin se "duhet të kenë qenë studentët, nxënësit dhe shehlerët që e sollën *Saadi-zmën* nga

Siria në rajonet shqiptare, ku ajo u shpërnda dhe hodhi rrënjë në një numër qytetesh e fshatrash. Nga gjiri i shqiptarëve doli një nga gjenitë e këtij tarikati, *Sheh Sulejman Axxhize Baba* i Gjakovës, që u mbiquajt: “Mësuesi i Dytë i Madh”, duke pasur parasysh se “Mësuesi i Parë i Madh” ishte Saad Al-Dini i Xhibavisë.⁶⁾

Sheh Sulejman Axxhize Baba kishte mbaruar studimet e larta fetare e civile për filozofi e sociologji në Stamboll dhe ishte nisur për në Damask të Sirisë, ku shehlerët e tarikatit *Saadi* propagandonin idetë liberale të Shenjtorit *Saad Al-Din Al-Xhibaviut*. Ishte koha kur sulltanët i kishin përqendruar të gjitha pushtetet në duart e tyre; kur “guri i tolerancës, mbi të cilin mbështetej Perandoria Osmane, siç shprehet historiani Ferdinand Schevill, kishte marrë të çarat e para dhe shkëlqimi i dikurshëm i Perandorisë Osmane kishte filluar të perëndonte”. Ushtritë perandorake osmane ishin thyer nga trupat austriake, polake, ruse e veneciane dhe të dërguarit e sulltanit ishin detyruar të uleshin për të nënshkruar paqen e Karlovicit në Hungarinë e Jugut (1699). Ndërkohë, kombësitë e nënshtruara nga osmanët, si: egjiptianët, arabët, sirianët, grekët, serbët, shqiptarët, maqedonasit, bullgarët e të tjerë, po përgatiteshin për të rinisur kryengritjet antiosmane. Kështu, në Damask flitej hapur se sulltani nuk e përmbushte kushtin kryesor për të qenë udhëheqësi shpirtëror i muslimanëve, pasi në dejtë e tij nuk rridhte asnjë pikë gjaku të fisit arab të Kurejshëve, prej nga kishte dalë Profeti Muhamed.⁷⁾

Në vitin 1699, *Sheh Sulejmani* ishte kthyer në Gjakovë, ku arriti të krijonte degën e tij të tarikatit *Saadi*, me emrin *Axxhize* (arabisht: *i vogël, i urtë, i mençur, i bindur, i përrulur*). Në vitin 1743, *Sheh Axxhize Baba* u shpërngul, së bashku me djalin e tretë, *Sheh Abdylvehab Efendinë*, në teqenë e re e të bukur të lagjes Marash të Prizrenit, ku shërbeu deri sa ndërroi jetë (1747). Në dy dokumente gjenealogjike (“*Silsilename*”), të zbuluara nga orientalisti Nehat Krasniqi, përmenden emrat e teqeve të tarikatit “*Saadi*”, të ngritura në shumë treva shqiptare, si: Vranja, Presheva e Bujanoci, Velesi, Gjilani e Prishtina, Shkupi, Tetova e Kumanova, Ulqini, Shkodra e Tropoja, Tirana, Tepelena e Vlora etj. Në të gjitha këto teqe

shërbyen qindra dervishë e shehlerë, të cilët ishin përgatitur si njerëz të ndershëm e atdhetarë të devotshëm në dy teqetë e mëdha të Gjakovës e Prizrenit nga Mësuesi i Dytë i Madh Sheh Sulejman Axhize Baba dhe djemtë e tij: Sheh Danjoll Baba e Lutfullah Efendi Baba të *Teqes së Madhe* të Gjakovës dhe Sheh Abdylvehab Efendi Baba i *Teqes së Marash-Hisarit* të Prizrenit. ⁸⁾

Në enciklopedinë "*Kamus Al-A'Lam*", Sami Frashëri shkruan se në vendlindjen e tij, në fshatin Frashër të Përmetit, kishte "një teqe të tarikatit "*Bektashi*" dhe një tjetër të tarikatit "*Saadi*". Në arkivat osmane përmendet një teqe "*Saadi*" e Ali Pashë Tepelenës, si dhe një tjetër teqe "*Saadi*" e Ibrahim Pashës, po në Tepelenë. Përveç Tepelenës e Frashërit, studiuesi Robert Elsie na jep të dhëna "për praninë e teqeve e tyrbeve të tarikatit "*Saadi*" në Gjirokastër, Leskovik, Elbasan, Tropojë dhe në Pezë (Tiranë)". Po ashtu, duke trajtuar përhapjen gjeografike të tyrbeve të këtij tarikati në Shqipëri, Sheh Ismail Halit Aga numëron 9 tyrbe e 1 teqe në Tropojë, 3 tyrbe në malësinë e Hasit, 1 tyrbe në Klos të Matit, 1 teqe e 1 tyrbe të *Baba Danjollit* në Tepelenë, 1 teqe e 1 tyrbe të *Baba Haxhi Zenelit* në fshatin Mazhar të Vlorës, një teqe e tyrbe të *Baba Hasanit* në Pezë të Tiranës etj. ⁹⁾

Rreth kohës së ndërtimit të teqesë së Pezës

Të gjithë studiuesit e tarikatit *Saadi* shprehen unanim se e para teqe e tarikatit "*Saadi*", e ngritur në trojet shqiptare, është ajo e Demir Hanit në Tepelenë. Jetëshkrimi i Demir Hanit daton para vitit 1630, thotë studiuesi Robert Elsie. Ai ishte dorëzuar dervish në teqenë e tarikatit "*Saadi*" në Xhiba të Damaskut, vendlindjen dhe qendrën e predikimeve të Mësuesit të Parë të Madh, Saaddedin Xhibaviut. Pasi ishte pajisur me *Hilafetnamenë* e tarikatit "*Saadi*" nga shehu Husein Tusi, Demir Hani kishte mbërritur në Vokopolë të Beratit, ku kishte takuar dervishin Mustafa Tusi dhe së bashku kishin shkuar për vizitë te varri i Abaz Aliut në malin e Tomorrit. Sipas këshillave të Sheh Tusiut të Vokopolës, Demir Hani kishte marrë vendim për t'u nisur drejt Tepelenës, ku kishte ngritur edhe të parën teqe të tarikatit "*Saadi*". Tyrbja e ngritur pas vdekjes së këtij shenjti

në Tepelenë ishte bërë vend pelegrinazhi për ndjekësit e tarikatisë "Saadi" dhe "Bektashi". Këtë teqe e kishte ripërtërirë rreth viteve 1706-1708, Sheh Danjoll Baba i Teqesë së Madhe të Gjakovës, i biri i Sheh Sulejman Axhize Babës. "E dyta teqe e vjetër e tarikatisë Saadi, thotë Sheh Ismail Aga, është ajo e fshatit Maxhar të Sevasterit të Vlorës dhe e treta vjen *Teqeja e Sheh Hasanit të Pezës*." Sipas gjenealogjisë që ka hartuar Sheh Ismail Aga dhe verifikimit të saj me të dhënat gojore të stërnipërve të tij në Pezën e Madhe, dervish Hasani nga Peza duket se mësimet e para fetare i ka marrë në Teqen e Marashit në Prizren, ndërsa *halifetnamenë* e Shehut e ka marrë nga dora e Sheh Shabanit Plak në teqenë e tij në Gjakovë.¹⁰⁾

Koha e përgatitjes së Sheh Hasanit në Prizren e Gjakovë duhet të llogaritet pas vitit 1743, kur është ngritur Teqeja e Marash Hisarit në Prizren dhe kthimi i tij në Pezë duhet të ketë ndodhur disa vite më parë se ai të ndërronte jetë (në vitin 1786). Sipas të dhënave dokumentare, në kohën e kthimit të Sheh Hasanit në Pezë kishte filluar shitblerja e tokës. Në një dokument të zbuluar nga historiani Ligor K. Mile thuhet: "Qysh nga vitet 1780 të shek. XVIII e deri në fillim të shek. XIX, shitblerje tokash u bënë në katundin-timar të Skroskës të Elbasanit, në Pezë, Shijak, në katundin Kullë, Jubë, Rreth, Pjeshkëz. Në këto të fundit, shitblerjet arrinin shumë prej rreth 40 mijë groshësh". Dhe më tej: "zhvendosje fshatarësh në toka më të përshtatshme për bujqësi u vunë re edhe në fushën e Tiranës, sidomos në zonën e Pezës, ku, sipas albanologut të shquar Johan G. von Hahn, banorëve iu dha leja të zbrisnin nga lartësi të papërshtatshme për bujqësi".¹²⁾

Sheh Hasani e ka ngritur shtëpinë-teqe të tarikatisë së tij, Saadi, vetëm 6 kilometra larg teqesë së tarikatisë "Halveti", e ndërtuar 300 vjet më parë në shpatin jugor të mureve të kalasë së Ndroqit. Këtë teqe e përmend me emrin *manastir* edhe diplomati e albanologu i shquar gjerman Johann G. von Hahn në shënimet e tij të udhëtimit të vitit 1863. "Në shpatin jugor të malit të kalasë ndodhej një manastir i pasur dervishësh, shehu i lashtë i të cilit nderohej në të gjithë vendin si gjysmë shenjtor", shkruan ai. Duke iu referuar një mbishkrimi arab, të gjetur në muret e teqes, Hahn shpreh mendimin se data e ndërtimit të

saj duhet të ketë qenë viti 888 i Hixhras (afërsisht viti 1480). Në këtë mënyrë, pra, saktëson ai, “themelimi i këtij manastiri duhej të ishte bërë pothuajse menjëherë pas nënshtrimit të plotë të Shqipërisë ndaj zotërimit turk”.¹³⁾

Me këtë rast, duhet thënë se jo të gjithë shqiptarët u islamizuan; se islamizimi i pjesës që përqafoi Islamit zgjati rreth 400 vjet (shek. XIV-XVIII); se doktrina e *Islamit Suni*, që e pranonte sulltanin si autoritetin e vetëm juridik, nuk arriti dot të vendoste Kodin Civil në jetën e brendshme të shqiptarëve që vazhdonin të rregullonin marrëdhëniet midis tyre me anën e kanuneve zakonore krahinore; se islamizimi masiv i rajoneve fshatare në vend të *Islamit Suni*, u përqafoi kur u shfaqën tarikatet islamike liberale, të përfaqësuara nga teqetë, shehlerët e dervishët liberalë. Brenda shtëpisë, *saadi*-të respektojnë kultin e nënës, e cila nuk pengohet kurrë të marrë pjesë në kuvendet apo luftërat e fisit e krahinës; ashtu siç respektohet edhe dalja e çdo gruaje me fytyrë të zbuluar në mjediset publike.¹⁴⁾

Historiani Kristo Frashëri pohon se *bektashizma* e *saadizma*, si dhe tarikatet e tjera, kanë në themel të filozofisë së tyre “*prirjen liberale për të bashkëjetuar me popullsitë e krishtera*”; ato predikojnë “*bashkimin kombëtar përpara atij fetar*”. Vështruar në optikën historike, siç shkruan edhe studiuesi Hysen Kordha, teqetë, si institucione dhe faltore kulturi dhe baballarët e dervishët, që shërbyen në to, u bënë shprehës dhe realizues të aspiratave kombëtare të brezave që luftuan për lirinë, pavarësinë e tërësinë tokësore të Shqipërisë.¹⁵⁾

Ndonëse nuk i referohet ndonjë dokumenti, studiuesi Sheh Ismail Aga ka shënuar si datë të vdekjes së Sheh Hasanit të Pezës vitin 1786, vit në të cilin pasardhësit ngritën edhe tyrben e tij. Gjithsesi, data 1786 përkon edhe me thëniet e stërnipërve të tij, të cilët numërojnë pas vdekjes së Baba Hasanit edhe katër breza shehlerësh e dervishësh: brezi I: Baba Ahmeti; brezi II: Baba Abdyli e dervishët Hasan II e Luftullah; brezi III: Baba Azizi e dervishët Sulo, Ali e Abdyrrahman; brezi IV: Baba Myrtezai, i cili u transferua në teqenë e bektashive të Fushë-Krujës, dhe dervishët Gani e Shyqyri Peza.

Pasardhësi i Baba Hasanit, i biri i tij, Baba Ahmeti i Teqesë së Pezës jetoi ngjarjet e mëdha të qëndresës së dy pashallarëve

të mëdhenj: Karamahmud Pashë Bushatlliut e Ali Pashë Tepelenës ndaj pushtuesve osmanë; i nipi i tij, Baba Hasani II, përjetoi kryengritjet e shkëputura të krahinave shqiptare kundër reformave të njohura të Tanzimatit, ndërsa stërnipi, Baba Abdyli, mori pjesë në krijimin e degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në krahinën e Pezës dhe mbështeti rezistencën e bashkëfshatarëve të tij pezakë kundër ekspeditës ndëshkimore të famëkeqit Shefqet Turgut Pasha, në ditët e fundit të Lidhjes, në qershor të vitit 1881.¹⁶⁾

Kontribute të teqesë së Pezës në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare

Në një “historik” të përmbledhur nga mësuesit e shkollës së Pezës së Madhe, thuhet se në kohën e Lidhjes Shqiptare krahina e Pezës ishte lidhur me administratën e Prizrenit. Në zonën midis lumenjve Erzen e Shkumbin ishte themeluar dega e Lidhjes së Prizrenit, me përfaqësues nga katundet: Arbanë, Baldushk, Bulticë, Cikallesh, Çaus, Damjan, Dorëz, Grecë, Gror, Gjuzsulkonaj, Kryezi, Lis- Patros, Leshtenj-Çollak, Maknor, Pajanë, Pezë e Madhe, Pezë e Vogël, Varosh etj. Në krye të kësaj dege ishte zgjedhur një pleqësi, me emrin *komitet*, në të cilin Peza e Madhe përfaqësohej nga *Babë Sheh Abdyl Peza dhe vëllezërit Sulejman, Sadi e Mustafa Çelmeta*. Nën drejtimin e këtij komiteti, pezakët spastruan zonën nga pushtuesit osmanë dhe administrata e tyre. Ata nuk pranonin të paguanin taksa dhe të dërgonin djemtë nizamë. Krahina vetëqeverisej nga *komiteti* dhe, gjatë tre vjetëve të jetës së Lidhjes së Prizrenit, aty nuk kishte shkelur as edhe një përfaqësues i pushtetit civil apo ushtarak i Perandorisë Osmane.¹⁷⁾

Pas betejave të përgjakshme kundër forcave vullnetare të Lidhjes Shqiptare në Slivovë (20 prill 1881), Shtimje (21 prill 1881) e Caralevë (22 prill 1881), Dervish Pasha hyri në Prizren dhe 24 batalionet e tij filluan arrestimet e ndjekjet e aktivistëve të Lidhjes Shqiptare në të gjitha trojet shqiptare. Në Shqipërinë e Mesme, ekspeditat ndëshkimore osmane të Dervish Pashës zhvilluan dy operacione: një në luginën e Zhullimës dhe tjetrin në luginën e Pezës. Shtatë taborë, të komanduar nga një

pasha osman, mundën të depërtonin deri në Pezë të Madhe, por aty, fshatarët e armatosur pezakë, të komanduar nga tre vëllezërit Mustafa, Sadi e Sulë Çelmeta, i gozhduan në vend. Luftimet u zhvilluan rreth e rrotull teqesë së Pezës, në Kodrën e Postës, në Lagjen Bec, në Çelmetje e në Danoshë. Sipas tregimeve të më të moshuarve, në atë betejë pashai osman la 50 ushtarë osmanë të vranë, kurse nga pezakët u vranë vetëm pesë vetë. Në atë luftë u plagos edhe Sadi Çelmeta, i cili mundi të arratisesh së bashku me shokët. Gjithsesi, ekspedita osmane e Dervish Pashës mundi të arrestonte e të internonte në Sinop të Anadollit 20 burra pezakë, të cilët u bënë pjesë e armatës së 7.000 shqiptarëve të arrestuar në Kosovë, Shqipërinë Qendrore e Jugore dhe të internuar në Anadoll dhe Azinë e Vogël.¹⁸⁾

Gjithsesi, nga të njëzet të internuarit pezakë, tetëmbëdhjetë vdiqën në Sinop të Anadollit; vetëm dy vetë mundën të ktheheshin pas 20 vjetësh të gjallë në Pezë; këta ishin Mustë e Sulë Çelmeta. Ata u kthyen në Pezë së bashku me kujtimin e pashlyeshëm të asaj lufte heroike; e cila do të përsëritej fiks pas 60 vjetësh, e udhëhequr nga nipi i sheh Abdyl Pezës, Myslim Peza dhe nipërit e vëllezërve Çelmeta, Xheladin, Emin e Fadil Çelmeta, tashmë kundër pushtuesve fashistë.

Pas Babë Sheh Abdylit, në teqen e Pezës shërbeu i biri, Aziz Peza. Saadi-të predikojnë lirinë dhe vetëqeverimin e çdo njeriu për të bashkëbiseduar me Allahun drejtpërsëdrejti, pa ndërmjetësinë e të tjerëve. "Në këtë tarikat, shkruan Baba Rexhepi, përmendja (ziqri) zë vendin e parë, gjë të cilën e shpjegojnë kështu: si çdo të sëmuri që doktori më parë i jep bar për të larë barkun, pastaj e mjekon me barëra të tjera sëmudjen, ashtu edhe për zemrën, bari i parë është përmendja, e cila pastron ndyrësitë e epsheve dhe i përgatit terrenin për ta zbukuruar me parimet e tjera, që kështu të përsoset njeriu".¹⁹⁾

Sipas stërnipërve dhe bashkëfshatarëve të tij pezakë, baballarët e dervishët e teqesë së Pezës predikonin, ndër të tjera edhe këto fjalë të urta: "Gjatë jetës së tij njeriu duhet të ruhet nga rrena, lakmia, urrejtja, mendjemadhësia, vjedhja, dyfytirësia e të tjera. E vërteta e shpëton njeriun; e shtremta një orë mban, e vërteta sa të jetë jeta. I pari vend i shenjtë asht Atdheu, toka ku ke lindë e je rritë; toka qi mbrohet me gjak e besë. Kush ka besë, gjen

pjesë; kush mban fjalën, mban dhe fenë; naltësia e mirësisë vjen nga besa; i poshtri nuk ka besë; shokun e mirë mos e quej pak; mikut i ec mbas nderit që ka e që të ban. Ec te miqtë, të të shtohet rrethi. Fjal' e pëlqyme asht e shkurtën, plag' e gjuhës asht ma e keqe se plag' e thikës; fjala e kallxon se ç'ka njeriu në zemër; fjal' e butë gjuen zemrat, prandej zbutë fjalën të të duen..."

Teqeja e Pezës përjetoi edhe ngjarjet historike të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, të kryesuar nga patrioti Ismail Qemali. I biri i Babë Azizit, Shyqyri Peza, i kreu shërbimet e fundit dëshmorit të parë pezak Avdi Berhysa, i cili u vra në luftën e Peqinit, më 1913, në përpjekje për të ndaluar marshimin e ushtrisë së Mbretërisë së Serbisë për pushtimin e Durrësit. Në shtëpinë e dervish Ganiut u ngrit e para shkollë shqipe në Pezë. Në ditët e përgatitjeve për mbajtjen e Kongresit historik të Lushnjës, më 1920, dervish Shyqyri Peza mblodhi në teqenë e Pezës rreth 60-70 bashkëluftëtarë pezakë dhe u nis në mbrojtje të delegatëve dhe kongresit historik për lirinë, pavarësinë e tërësinë tokësore të Shqipërisë.²⁰⁾

Në ditët e përflakura të Luftës së Dytë Botërore, në *ish-shtëpinë-teqe të Babë Hasanit të Pezës*, më 16 shtator 1942, u mbajt Konferenca e njohur në histori me emrin Konferenca e Pezës. Mbledhja e patriotëve shqiptarë në *Konferencën e Pezës* nuk pati karakter fetar; megjithatë, në tekstin e betimit të tyre solemn për t'u bashkuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, fraza e parë që u hodh në letër qe: "*pa dallim feje, krahine e ideje politike*".

Shënime:

- 1) Sheh Ismail Halil Aga, *Tarikatet islamike shqiptare. Saadizma*, Tropojë: "Eurorilindja", 1995, f. 20; *Tarikati Islamik "Saadi"*, Tiranë: "Eurorilindja", 1996, f. 82-84; Jashar Rexhepagiq, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, Kosovë (Pejë), "Dukagjini", 1999, f. 152-153; Shyqyri Hysi, *Histori e komuniteteve fetare shqiptare*, Tiranë, Mësonjëtorja, 2006, f. 130 (sipas Arkivit të Ministrisë së Rendit, Fondi i Drejtorisë së Dytë, viti 1958, dosja 62, fl. 67).
- 2) Sulejman Dashi, "Teqet e Shqipërisë. Aspekte të historisë dhe të arkitekturës", botuar në revistën "Perla", Tiranë, 1999, nr. 1, f. 105-106.
- 3) Shënime të mbledhura nga autori.
- 4) J. Rexhepagiq, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, vep. e përm., f. 139; Nehat Krasniqi, "Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimin e kulturës dhe civilizimit islam", botuar në revistën "Univers", Tiranë, 2007/9, f. 259.
- 5) Tyrabiu, Baba Ali: *Historia e Përgjithshme e Bektashinjve*, Mbroadhësia, Tiranë, 1929, f. 10; Arkivi i Bibliotekës Kombëtare, Tiranë: Sami Frashëri, *Kamus A'l A'lam*, Istambul, 1894, Vëll. IV, f. 2569. Enciklopedia "Kosova, dje dhe sot", Beograd, 1973, f. 473; H. T. Norris, *Islam in the Balkans*, London, "Hurts & Co", 1993, f. 245; Baba Rexhepi, *Mistiçizma dhe bektashizma*, Tiranë, 1995, f. 84; J. Rexhepagiq, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, vep. e përm., f. 71.
- 6) H. T. Norris, *Islam in the Balkans*, vep. e përm., f. 246 (shih: Nathallie Clayer, *Second International Congress on History of Syria (1516-1939)*, part one, Damascus 1980: *Sa'diyya in Albania*, pp. 163-172).
- 7) Ferdinand Schevill, *Ballkani-Historia dhe Qytetërimi*, përkthyer nga Mitro Çela dhe Enian Çela, Tiranë: Uegen, 2002, f. 178, 180, 218; Bozborra, Nuray: *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, përkthyer nga Dritan Egro, Tiranë: Dituria, 2002, f. 51.
- 8) Nehat Krasniqi, *Dy dokumente gjenealogjike të rëndësishme*, artikull i botuar në revistën "Dituria islame", Prishtinë, 1994, nr. 59, f. 14 dhe "Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimin e kulturës dhe civilizimit islam", vep. e përm., f. 259.
- 9) Sami Frashëri, *Vepra 2*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1988 (sipas *Kamus A'l A'lam*, vëll. V, f. 3352); Robert Elsie, "A dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture" (2000, 2005); përkthyer në shqip nga Abdurrahim Myftiu, me titull: *Leksiku i Kulturës Popullore Shqiptare, besim, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore*, Tiranë: Skanderbeg boks, 2005, f. 180; Sheh Ismail Halil Aga, *Tarikatet islamike shqiptare. Saadizma*, vep. e përm., f. 20, 47.
- 10) R. Elsie, *Leksiku i Kulturës Popullore Shqiptare*, vep. e përm., f. 43-44; Sheh Ismail Halil Aga, *Tarikati Islamik "Saadi"*, vep. e përm., 84, 90-93.
- 11) *Historia e popullit shqiptar*, vëllimi I, Tiranë: Toena, 2002, f. 587; N. Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar...*, vep. e përm., f. 56.
- 12) Ligor K. Mile, *Çështje të historisë agrare shqiptare*, Akademia e Shkencave (Instituti i Historisë), Tiranë 1984, f. 45, 53 (sipas AQSH, Fondi 68, viti 1803, dosja 28/1 dhe J. G. von Hahn, *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar*. Wien, 1867, f. 12).
- 13) J. G. Hahn, *Nëpër viset e Drinit e të Vardarit*, përkthyer nga Pjetër Radiqi,

Tiranë: Geer, 2001, f. 21.

14) *Historia e popullit shqiptar* (2002), vep. e përm., vëll. I, f. 183, 579, 585-594; N. Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar...*, f. 62.

15) Kristo Frashëri, "Naim Frashëri dhe bektashizmi shqiptar", kumtesë e mbajtur në Seminarin XVII Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", Tiranë, 16-31 gusht 1995, f. 670; Hysen Kordha, "Teqet, vatra të mësimit të gjuhës shqipe", në revistën "Studime historike", Tiranë, 2006, f. 151.

16) Sheh Ismail Halil Aga, *Tarikati Islamik "Saadi"*, vep. e përm., f. 91; të dhëna gojore nga Gani Peza (katundi Peza e Madhe).

17) *Historiku i fshatit Peza e Madhe*. Nga kopja e arkivit personal të autorit, f. 2; Nazmi Çelmeta, *Vështrim i shkurtër historik i zonës së Pezës*, botuar në gazetën "Peza", nr. 8 (69), gusht 2006, f. 5.

18) K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, vep. e përm., f. 411-412; N. Çelmeta *Vështrim i shkurtër historik i zonës së Pezës*, vep. e përm., f. 5.

19) B. Rexhepi, *Mistiçizma dhe bektashizma*, vep. e përm., 84.

20) Siri Shaplllo, *Nga zhvillimi i Arsimit në Shqipëri*, Tiranë: 8 Nëntori, 1975, f. 76; Ilir Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore*, Tiranë, Neraida, 2001, f. 58-69; K. Frashëri, *Historia e Tiranës*, vëll. I, vep. e përm., f. 382-83, 386; Murat Gecaj, *Nëpër udhët e shkollës shqipe*, Tiranë: Erik, 2001, f. 153.